



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada -Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Ministarstvo za Finansije, Rad i Transfere – Ministry of Finance, Labour and Transfer

Agjencia Qendrore e Prokurimit / Centralma Agencija Nabavke/Central Procurment Agency

RAPORT VJETOR I PUNËS I AGJENCISË QENDRORE TË PROKURIMIT

PËR VITIN 2024

Përmbledhje Ekzekutive

Në përputhje me detyrimin ligjor, Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) përgatitë dhe i dorëzon ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve një raport vjetor, që pasqyron aktivitetet e prokurimit publik të udhëhequra nga AQP-ja për atë vit kalendarik. Raporti Vjetor për vitin 2024 i përshkruan aktivitetet e AQP-së në vitin paraprak dhe informon institucionet përkatëse, operatorët ekonomikë dhe të gjithë akterët profesionistë rreth funksionimit të AQP-së. Organizimi i brendshëm dhe funksionimi i AQP-së janë përcaktuar me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës.

AQP administrohet nga një drejtor i emëruar për një periudhë tre (3) vjeçare. Drejtori udhëheq, organizon dhe drejton punën dhe veprimtarinë e AQP-se dhe është përgjegjës për punën profesionale të AQP-se.

Fushëveprimi i AQP-së, konform Ligjit për Prokurimin Publik, trajton dy (2) lloje kryesore të procedurave të prokurimit:

1. Kontratat e Centralizuara – AQP udhëheq aktivitetet në emër të të gjitha Autoriteteve Kontraktuese; dhe,
2. Kontratat e veçanta – AQP udhëheq aktivitetet për Agjencitë e Pavarura të cilat i përgjigjen Kuvendit të republikës së Kosovës, që kanë më pak se 50 (pesëdhjetë) punonjës dhe aktivitetet në emër të institucioneve të tjera, me aprovim të Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve.

Në kuadër të **kontratave të centralizuara** gjatë vitit 2024 DPC ka zhvilluar procedurat e prokurimit për aktivitetet e cekura në Vendimit të Qeverisë nr. 02/194 të datës 20.03.2024. AQP gjatë vitit 2024 ka iniciuar aktivitetet e prokurimit për 14 (katërmëdhjetë) artikujt për përdorim të përbashkët të paraparë në vendimin e vitit 2024.

Nga aktivitetet e prokuruar nga DPC janë nënshkruar **43 kontrata** me vlerë **55,588,032.47€**. Vlera e parashikuar e këtyre kontratave ishte **58,568,836.00 €**, ndryshimi/kursimet e mundshme në mes të vlerës së parashikuar dhe vlerës totale të kontratës janë **2,980,803.53€**. Tri nga këto kontrata janë marrëveshje kornizë në vlerën totale prej **16,000,000.00 €**.

Në kuadër të DPV gjatë vitin 2024, AQP ka iniciuar **91 (nëntëdhjetë e një)** aktivitetet dhe në kuadër të këtyre aktiviteteve ka nënshkruar **123 (njëqind e njëzetë e tri)** kontrata në vlerë totale prej **3,461,840.85€**. Vlera e parashikuar për këto 123 kontratat ishte **4,202,004.35€**. Ndryshimi/kursimet e mundshme në mes të vlerës së parashikuar dhe vlerës totale të kontratës janë **740,163.50 €**.

Të gjitha dokumentet e prokurimit të AQP-së publikohen rregullisht në përputhje me dispozitat ligjore të transparencës dhe me qëllim të promovimit të veprimtarive brenda komunitetit të biznesit, autoriteteve kontraktuese dhe publikut të gjerë.

Me anë të kontratave të centralizuara është arritur një sukses i dukshëm në kursimin e kohës dhe punës të punonjësve të institucioneve publike dhe operatoreve ekonomikë dhe në uljen e numri të procedurave të prokurimit publik në Republikën e Kosovës.

Lista e shkurtesave

AQP – Agjencia Qendrore e Prokurimit

AK – Autoritet Kontraktues

DFSHP - Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

DPC – Drejtorati i Prokurimeve të Centralizuara

DPV - Drejtorati i Prokurimeve të Veçanta

IKAP – Instituti i Kosovës për Administratë Publike

KRPP – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

LPP – Ligji i Prokurimit Publik

OE – Operator Ekonomik

MF – Ministria e Financave

RUOPP - Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

UA – Udhëzimi Administrativ

Përmbledhja

1. Korniza ligjore	5
2. Struktura organizative	6
3. Drejtorati për Prokurime të Centralizuara.....	7
4. Drejtorati për Prokurime të Veçanta.....	12
5. Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme	13
6. Aktivitete tjera të zyrtarëve të AQP-së	14
7. Trajnimi	14
8. Çështjet që ndikojnë në efikasitetin e AQP-së & Rekomandimet	14
Aneksi 1. STRUKTURA ORGANIZATIVE	16
Aneksi 2. Lista e aktiviteteve të prokurimit që kanë përfunduar me nënshkrimin e kontratave nga DPV	17
Aneksi 3. TABELA E PJESEMARRSVE NE TRAJNIME	28

1. Korniza ligjore

Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) është agjenci ekzekutive që funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave Punës, dhe Transferove (MFPT).

AQP është Autoritet Publik dhe Organizatë Buxhetore në kuadër të MF dhe i nënshtrohet ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë çështjet administrative. Në bazë të Ligjit mbi Prokurimin Publik (LPP) në Kosovë Nr. 04/L-042, neni 95, *i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (LPP)*, AQP ka përgjegjësinë:

- Me aprovimin paraprak të Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve, mund të kryej në emër të një Autoriteti Kontraktues (AK) një apo më shumë aktivitete të prokurimit, me qëllim të ekonomizimit të shpenzimeve (Neni 95, paragrafi 1, i LPP-së);
- Qeveria, sipas propozimit të Ministrit të MFPT-së përpilon një listë të mallrave apo artikujve të përdorimit të përbashkët, që miratohet në formën e një udhëzimi administrativ. Lista e tillë dhe çdo ndryshim i bërë në të do të publikohet në media dhe shpallet në faqen e internetit të KRRPP-së (Neni 95, paragrafi 2 i LPP-së). AQP, pas miratimit të listës së artikujve të përdorimit të përbashkët, zhvillon aktivitetet e prokurimit për procedurat e centralizuara në emër të AK-ve, në nivel qendror dhe nivel lokal;
- Me aprovim paraprak, mund të udhëheq në emër të një AK-je, një aktivitet prokurimi (Neni 95, paragrafi 4);
- Një AK mund të kërkojë nga AQP-ja që ta ndihmojë AK në fjalë në kryerjen e një aktiviteti të prokurimit (Neni 95, paragrafi 4);
- Gjithashtu, kryen procedurat e prokurimit për Agjencitë e Pavarura të cilat i përgjigjen Kuvendit të Republikës së Kosovës, që kanë më pak se pesëdhjetë (50) punonjës (Neni 21/A paragrafi 2 i LPP-së).

Të gjitha kontrata e nënshkruara nga AQP janë obligative për AK-të.

AQP është përgjegjëse për kryerjen e procedurave të prokurimit deri në nënshkrim të kontratës, ndërsa menaxhimi i kontratës bëhet nga AK-të, të cilat i shfrytëzojnë këto kontrata.

Të gjitha obligimet monetare që rrjedhin nga këto kontrata do t'i paguajnë AK-të nga kodet e tyre buxhetore.

2. Struktura organizative

Agjencia Qendrore e Prokurimit përbehet nga tri drejtorate: Drejtorati për Prokurime të Centralizuara (DPC); Drejtorati për Prokurime të Veçanta (DPV) dhe Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme (DFShP), shih Aneksin # 1.

Vlen të theksohet se sipas Ligjit Nr. 06 L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të agjencive të pavarura, si dhe Ligjit Nr.06 L-114 për zyrtarët publik, Drejtoritë shndërrohen në Departamente.

2.1 DPC Drejtorati për Prokurime të Centralizuara (DPC)

Drejtorati për Prokurime të Centralizuara (DPC) udhëheqë aktivitetet e centralizuara për AK-të në nivel qendror dhe në nivel lokal;

Përfitimet e mundshme të prokurimeve të centralizuara:

- Me prokurime të centralizuara sigurohen çmime më të mira për shkak të ekonomisë së shkallës përmes blerjes me shumicë;
- Specifikimet e standardizuara për mallra dhe shërbime shpijnë në mallra apo shërbime me kualitative;
- Mundësia e situatave të mundshme të 'konfliktit të interesit' zvogëlohet përmes ndarjes së agjencisë kontraktuese dhe kontraktuesve;
- Puna e përbashkët, nga AQP-ja dhe Njësitë Kërkuuese, në hartimin e specifikimeve teknike dhe pjesëmarrjen në procesin e tenderimit rrit kompetencat e personelit të Njësisë Kërkuuese në fusha të veçanta të prokurimit publik;
- Procedurat e ankesave do të modernizohen për shkak se ka vetëm një operator ekonomik që bën një ankesë kundër dhënies së kontratës kornizë në krahasim me numrin e madh të mundshme nga një formë e decentralizuar e prokurimit.

DPC, në fund të vitit 2024 ka të punësuar 5 punëtorë dhe ka këtë strukturë:

Kostoja e kësaj Drejtorie në vitin 2024 ishte rreth **45,500 €** bruto për të gjithë zyrtarët.

2.2 DPC Drejtorati për Prokurime të Veçanta(DPV)

Drejtorati për Prokurime të Veçanta (DPV) udhëheq aktivitetet e prokurimit për Agjencitë e pavarura DPV, në fund të vitit 2024 ka të punësuar 4 punëtorë dhe ka këtë strukturë:
Kostoja e kësaj Drejtorie në vitin 2024 ishte rreth **35,700 €** bruto për të gjithë zyrtarët.

2.3 DPC Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme (DFSHP).

DFSHP në fund të vitit 2024 ka të punësuar 4 punëtorë dhe ka këtë strukturë:
Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme:
Përkthyesja e gjuhës serbe;
Zyrtarja e lartë e personelit;
Zyrtarja ligjore;
Zyrtar i logjistikes
.Kostoja e kësaj Drejtorie në vitin 2024 ishte rreth **38,600 €** bruto për të gjithë zyrtarët.

3. Drejtorati për Prokurime të Centralizuara

Drejtorati për Prokurime të Centralizuara (DPC), konform Nenit 95, pika 2 të LPP-së dhe Vendimit të Qeverisë nr. 02/194 të datës 20.03.2024, vendim i cili ndryshon listën e mallrave ose artikujve të përdorimit të përbashkët, respektivisht Udhëzimin Administrativ QRK-Nr.06/2018 për zbatimin e Prokurimeve Qendrore të Prokurimit Publik, pas miratimit të listës së artikujve të përdorimit të përbashkët nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2024, ka zhvilluar aktivitetet e prokurimit për procedurat e centralizuara të miratuara në këtë Vendim.

Kryerja e procedurave të centralizuara është bërë në pajtim me legjislacionin që rregullon çështjet e prokurimit publik në Kosovë dhe Udhëzimit Administrativ të aprovuar nga Qeveria për listën e artikujve të përdorimit të përbashkët.

Në Vendimin e Qeverisë nr. 02/194 të datës 20.03.2024, lista e artikujve përbehej nga dymbëdhjetë (12) aktivitete në nivel qendror dhe lokal.

Nr.	Lista e artikujve sipas Vendimit të Qeverisë nr. 02/194 të datës 20.03.2024	Lloji i kontratës	Kohëzgjatja
1	Furnizimi me letër për kopje	Kontratë Kornizë	2 Vite
2	Furnizimi me material zyrtar	Marrëveshje Kornizë	3 Vite
3	Furnizimi me vetura të udhëtarëve	Kontratë Kornizë	1 Vit
4	Furnizim me artikuj ushqimor	Kontratë Kornizë	1 Vit
5	Furnizim me mobilje	Kontratë Kornizë	1 Vit
6	Furnizim me pajisje të teknologjisë informative	Marrëveshje Kornizë	3 Vite
7	Furnizim me pemë dhe perime	Marrëveshje Kornizë	3 Vite
8	Vetura me qira	Kontratë Publike Afatgjate	5 Vite
9	Shërbime fotokopjimi, skanimi dhe printimi – me qira	Kontratë Publike Afatgjate	3 Vite
10	Furnizimi me karburante	Kontratë Kornizë	1 Vit
11	Furnizimi me mazut	Kontratë Kornizë	2 Vite
12	Furnizimi me ujë të pijes	Kontratë Kornizë	3 Vite

Gjate vitit 2024, DPC ka zhvilluar procedurat e prokurimit për aktivitetet e cekura në Vendimit të Qeverisë nr. 02/194 të datës 20.03.2024 të publikuar në ueb faqen e AQP-së, KRPP-së dhe Qeverisë. Bazuar në vendimin e Qeverisë, DPC ka zhvilluar procedurat e prokurimit për të gjitha aktivitetet e cekura duke hequr ato për të cilat AQP ka kontrata aktive (në implementim e sipër) në vitin 2024 nga vitet paraprake.

AQP gjatë vitit 2024 ka iniciuar dymbëdhjetë (12) aktivitete, për të gjithë listën e artikujve për përdorim të përbashkët sipas Vendimit të Qeverisë nr. 02/194 të datës 20.03.2024.

Kriteri i shpërblimit më i përdorur në këto aktivitetet është kriteri “Tenderi i përgjegjshme me çmimin më të ulët” ndërsa tek Furnizimi me Vetura dhe Marrja me qera e Veturave, pra janë dy aktivitete ku është përdorur kriteri çmimi ekonomikisht më i favorshëm. Po ashtu, në mënyrë që të rritet konkurrenca, AQP ndan aktivitetet e prokurimit në pjesë (Lot), si tek procedura Furnizim me karburante që ka qenë e ndarë në nëntë (9) pjesë (Lot) apo procedura për Furnizim me Artikuj Ushqimor aktiviteti ka qenë i ndarë në 6 pjesë (Lot) etj.

Nga aktivitetet e prokuruar nga DPC janë nënshkruar 43 kontrata me vlerë **55,588,032.47€**. Vlera e parashikuar e këtyre kontratave ishte **58,568,836.00 €**, ndryshimi/kursimet e mundshme në mes të vlerës së parashikuar dhe vlerës totale të kontratës janë **2,980,803.53€**. Tri nga këto kontrata janë marrëveshje kornizë në vlerën totale prej **16,000,000.00 €**.

Tabela e mëposhtme jep detaje të përmbledhura të kontratave të lidhura nga DPC:

Nr. rendor	Numri i prokurimit	Titulli i Kontratës	Data e nënshkrimit të kontratës	Vlera e parashikuar	Vlera e kontraktuar	Ndryshimet
1	UA/2016-23-5626-1-1-1	Furnizim me vetura për institucionet e Republikës së Kosovës - Modeli 2	10.5.2024.	€ 418,000.00	€ 413,050.00	€ 4,950.00
2	UA/2016-23-5626-1-1-1	Furnizim me vetura për institucionet e Republikës së Kosovës - Modeli 5	10.5.2024.	€ 207,000.00	€ 197,505.00	€ 9,495.00
3	UA/2016-23-5626-1-1-1	Furnizim me vetura për institucionet e Republikës së Kosovës - Modeli 6	10.5.2024.	€ 1,400,000.00	€ 1,286,040.00	€ 113,960.00
4	UA/2016-23-14002-2-1-1	Shërbimet e fotokopjimit, printimit dhe skanimit me qira - Lot 1 - Nivel qendror	27.3.2024.	€ 950,536.00	€ 914,890.90	€ 35,645.10
5	UA/2016-23-14002-2-1-1	Shërbimet e fotokopjimit, printimit dhe skanimit me qira - Lot 2 - Nivel qendror	27.3.2024.	€ 780,264.00	€ 741,250.80	€ 39,013.20
6	UA/2016-23-14002-2-1-1	Shërbimet e fotokopjimit, printimit dhe skanimit me qira - Lot 3 - Nivel qendror	1.3.2024.	€ 935,200.00	€ 806,610.00	€ 128,590.00
7	UA/2016-24-4073-1-1-5	Lot 1 - Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit (Lot 3 në procedurën e hapur)	30.4.2024.	€ 181,000.00	€ 136,606.50	€ 44,393.50
8	UA/2016-24-4073-1-1-5	Lot 2 - Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor (Lot 5 në procedurën e hapur)	30.4.2024.	€ 281,000.00	€ 268,643.50	€ 12,356.50
9	UA/2016-23-14297-1-1-1	Furnizim me Tavolina pune dhe dollapa	20.5.2024.	€ 185,000.00	€ 148,812.50	€ 36,187.50
10	UA/2016-23-14297-1-1-1	Furnizim me inventar shkollorë	20.5.2024.	€ 2,250,000.00	€ 1,667,442.50	€ 582,557.50
11	UA/2016-23-14297-1-1-1	Furnizim me karrige	20.5.2024.	€ 530,000.00	€ 393,190.00	€ 36,810.00
12	UA/2016-24-3284-1-1-1	Lot 1 - Furnizim me letër per kopje - Nivel Qendror	1.7.2024.	€ 620,000.00	€ 530,905.00	€ 9,095.00
13	UA/2016-24-3284-1-1-1	Lot 2 -Furnizim me letër per kopje - Nivel Lokal	1.7.2024.	€ 840,000.00	€ 722,405.00	€ 117,595.00
14	UA/2016-23-14341-2-1-1	Shërbimet e fotokopjimit, printimit dhe skanimit me qira Lot 6 - Rajoni i Gjilanit - Nivel Lokal	21.6.2024.	€ 240,000.00	€ 228,000.00	€12,000.00
15	UA/2016-23-14341-2-1-1	Shërbimet e fotokopjimit, printimit dhe skanimit me qira Lot 1 - Rajoni i Prishtinës - Nivel Lokal	21.6.2024.	€ 480,000.00	€ 444,000.00	€ 36,000.00
16	UA/2016-23-14341-2-1-1	Shërbimet e fotokopjimit, printimit dhe skanimit me qira Lot 2 - Rajoni i Mitrovicës - Nivel Lokal	21.6.2024.	€ 200,000.00	€ 200,000.00	€ -

17	UA/2016-23-14341-2-1-1	Shërbimet e fotokopjimit, printimit dhe skanimit me qira Lot 3 - Rajoni i Pejës dhe Gjakovës - Nivel Lokal	21.6.2024.	€ 220,000.00	€ 220,000.00	€ -
18	UA/2016-23-14341-2-1-1	Shërbimet e fotokopjimit, printimit dhe skanimit me qira Lot 4 - Rajoni i Prizrenit - Nivel Lokal	21.6.2024.	€ 220,000.00	€ 206,250.00	€ 13,750.00
19	UA/2016-23-14341-2-1-1	Shërbimet e fotokopjimit, printimit dhe skanimit me qira Lot 5 - Rajoni i Ferizajt - Nivel Lokal	21.6.2024.	€ 240,000.00	€ 237,000.00	€ 3,000.00
20	UA/2016-24-2858-1-1-1	Lot 2 - Furnizim me karburante për vetura për nevojat e institucioneve publike të Nivelit Qendror	10.7.2024.	€ 2,772,849.00	€ 2,772,312.94	€ 536.06
21	UA/2016-24-2858-1-1-1	Lot 5 - Furnizim me karburante për Rajonin e Prishtinës (Nivel Lokal)	10.7.2024.	€ 2,768,755.00	€ 2,763,799.64	€ 4,955.36
22	UA/2016-24-2858-1-1-1	Lot 9 - Furnizim me karburante për Rajonin e Mitrovicës (Nivel Lokal)	10.7.2024.	€ 752,084.00	€ 731,611.15	€ 20,472.85
23	UA/2016-24-2858-1-1-1	Lot 1 - Furnizim me karburante për nevojat e Policisë së Kosovës	10.7.2024.	€ 4,971,172.00	€ 4,965,584.78	€ 5,587.22
24	UA/2016-24-2858-1-1-1	Lot 3 - Furnizim me karburante për nevojat e MM dhe FSK-së	10.7.2024.	€ 1,803,249.00	€ 1,800,050.84	€ 3,198.16
25	UA/2016-24-2858-1-1-1	Lot 6 - Furnizim me karburante për Rajonin e Prizrenit (Nivel Lokal)	10.7.2024.	€ 896,737.00	€ 895,052.66	€ 1,684.34
26	UA/2016-24-2858-1-1-1	Lot 8 - Furnizim me karburante për Rajonin e Ferizajt dhe Gjilanit (Nivel Lokal)	10.7.2024.	€ 1,516,600.00	€ 1,513,207.34	€ 3,392.66
27	UA/2016-24-2858-1-1-1	Lot 7 - Furnizim me karburante për Rajonin e Pejës dhe Gjakovës (Nivel Lokal)	13.11.2024	€ 1,636,390.00	€ 1,593,957.52	€ 42,432.48
28	UA/2016-24-3651-1-1-1	Furnizim me Pemë Perime	12.8.2024.	€ 3,000,000.00	€ 3,000,000.00	€ -
29	UA/2016-24-3984-1-1-1	Furnizim me material zyrtar	22.8.2024.	€ 4,000,000.00	€ 4,000,000.00	€ -
30	UA/2016-23-9179-1-1-1	Lot 3 - Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit	3.9.2024.	€ 660,000.00	€ 586,850.00	€ 73,150.00
31	UA/2016-23-9179-1-1-1	Lot 5 - Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor	3.9.2024.	€ 1,050,000.00	€ 976,200.00	€ 73,800.00
32	UA/2016-24-3927-1-1-1	Marrëveshje kornizë – Furnizim me Pajisje të Teknologjisë Informative	16.9.2024.	€ 9,000,000.00	€ 9,000,000.00	€ -
33	UA/2016-24-7668-1-1-1	Lot 1 - Modeli 1	6.11.2024.	€ 289,000.00	€ 262,650.00	€ 26,350.00
34	UA/2016-24-7668-1-1-1	Lot 3 - Modeli 3	6.11.2024.	€ 374,000.00	€ 337,960.00	€ 36,040.00

35	UA/2016-24-7668-1-1-1	Lot 2 - Modeli 2	6.11.2024.	€ 1,450,000.00	€ 1,292,820.00	€ 157,180.00
36	UA/2016-24-7668-1-1-1	Lot 4 - Modeli 4	6.11.2024.	€ 1,188,000.00	€ 1,185,120.00	€ 2,880.00
37	UA/2016-24-7668-1-1-1	Lot 5 - Modeli 5	6.11.2024	€ 1,512,000.00	€ 1,402,200.00	€ 109,800.00
38	UA/2016-24-8838-1-1-1	Lot 1 - Furnizim me mish gjedhi dhe produkte të mishit të gjedhit	5.12.2024	€ 1,925,000.00	€ 1,700,550.00	€ 224,450.00
39	UA/2016-24-8838-1-1-1	Lot 2 - Furnizim me mish pule dhe produkte të mishit të pulës	5.12.2024	€ 700,000.00	€ 599,350.00	€ 100,650.00
40	UA/2016-24-8838-1-1-1	Lot 3 - Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit	5.12.2024	€ 795,000.00	€ 600,975.00	€ 194,025.00
41	UA/2016-24-8838-1-1-1	Lot 4 - Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor	4.12.2024	€ 1,850,000.00	€ 1,499,778.10	€ 350,221.90
42	UA/2016-24-8838-1-1-1	Lot 5 – Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor	4.12.2024	€ 1,180,000.00	€ 1,047,900.80	€ 132,099.20
43	UA/2016-24-8838-1-1-1	Lot 6 - Furnizim me bukë dhe brumëra të tjera	2.12.2024	€ 1,300,000.00	€ 1,297,500.00	€ 2,500.00
TOTALI				€ 58,568,836.00	€ 55,588,032.47	€ 2,980,803.53

4. Drejtorati për Prokurime të Veçanta

Drejtorati për Prokurime të Veçanta (DPV), konform Nenit 21/A, pika 2 dhe Nenit 95.4 të LPP-së, ka zhvilluar aktivitetet të prokurimit komform LPP-së në fuqi.

Në kuadër të aktiviteteve të zhvilluara nga DPC në vitin 2024, AQP ka iniciuar **nëntëdhjetë e një (91)** aktivitete dhe në kuadër të këtyre aktiviteteve ka nënshkruar **njëqind e njëzetë e tri (123)** kontrata në vlerë totale prej **3,461,840.85€**. Vlera e parashikuar për këto 123 kontratat ishte **4,202,004.35€**. Ndryshimi/kursimet e mundshme në mes të vlerës së parashikuar dhe vlerës totale të kontratës janë **740,163.50 €**, që i bie rreth **17.62%**.


Këto rezultate të kursimeve të mjeteve buxhetore janë arritur falë transparencës, punës profesionale që kane treguar zyrtaret e Drejtoratit të Prokurimeve të Veçanta dhe bashkëpunimit të mirëfillte me zyrtaret e Autoriteteve Kontraktuese për të cilat janë zhvilluar aktivitetet e prokurimit.

Vlera e parashikuar për aktivitetet e zhvilluara në bazë të nenit 21/A dhe 95.4 të LPP-së caktohet nga institucionet / njësitë e kërkesës kur dërgojnë kërkesat e tyre në AQP për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit dhe si rrjedhojë ka pasur aktivitete të cilat janë anuluar për arsye se ofertat e pranuar kane tejkaluar në mënyrë substanciale vlerën e parashikuar.

Lista e aktiviteteve të prokurimit që kanë përfunduar me nënshkrim të kontratave është e paraqitur në **Aneksin 2** të raportit.

DPV, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit, varësisht nga natyra apo vlera e parashikuar e kontratës, ka përdorur procedurën e hapur, kuotim të çmimit, procedurën e vlerës minimale apo procedurën e negociuar pa publikim.

VLERA E KONTRATAVE SIPAS LLOJEVE TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT	
Lloji i Procedurës	Vlera e kontratave:
Procedure e hapur	€ 2,875,850.42
Procedurë e negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës	€ 343,153.10
Procedure e kuotimit të çmimeve	€ 56,223.69
Procedurë e vlerës minimale	€ 17,566.22
Mini Tender	€ 169,047.42
Gjithsejtë	€ 3,461,840.85



Grafiku nr. 1. Vlera e kontratave të nënshkruara nga Drejtorati për Prokurime të Veçanta sipas llojit të procedurës

5. Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

Aktivitetet kryesore të realizuara të këtij drejtorati janë si më poshtë:

- Plotësimi i Draft Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në AQP, sipas komenteve nga DMZP;
- Planifikimi i buxhetit për vitin 2025, përgatitja e planit të rrjedhës së parasë në baza vjetore, tremujore dhe mujore;
- Përgatitja dhe dorëzimi i barazimeve mujore, tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore, njëvjeçare dhe barazimi me zyrën e kontabilitetit pranë Departamentit të Thesarit/MFPT;
- Realizimi i procesit të pagesave për vitin 2024;
- Finalizimi i Raportit për Pasqyrat Financiare për vitin 2024 në AQP
- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e informatave për burimet njerëzore, logjistike dhe përkthyesve.
- Zhvillimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të politikave dhe procedurave standarde lidhur me buxhetin, financat, burimet njerëzore, logjistike etj;
- Mbikëqyrja dhe monitorimi i proceseve të rekrutimit dhe çështjeve lidhur me BNJ, logjistike etj.

Në bazë të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, Agjencia Qendrore e Prokurimit, në tabelën në vijim ka prezantuar shpenzimet në totalin prej **238,449.82** Euro, nga tri (3) kategori të ndryshme ekonomike:

Kategoria: Mallra dhe shërbime /Paga dhe mëditje/Komunal	Shuma
Paga dhe mëditje Janar-Dhjetor 2024	146,169.03
Mallra dhe shërbime	91,449.81
Komunal/telefoni fikse	830.98
Totali	238,449.82

Siç vërehet edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme, AQP-ja nuk ka pas buxhet në kategorinë e kapitaleve, gjatë vitit raportues 2024.

Në nivel të AQP-së është ndryshuar dhe plotësuar Projekt Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencisë Qendrore të Prokurimit (AQP), sipas kërkesave dhe komenteve të institucionit përkatës në MPB, të cilën AQP-ja ende nuk e ka përcjellë në Ministrinë e Punëve të Brendshme për procedura të mëtejshme të miratimit, për shkak të paqartësisë se si dhe ku do të mbetet Agjencia Qendrore e Prokurimit, sipas plotësimeve dhe ndryshimeve ligjore në proces, të iniciuara nga Qeveria, lidhur me Ligjin e Prokurimit Publik.

6. Aktivitete tjera të zyrtarëve të AQP-së

- Konform dispozitave ligjore, kemi përgatitur Raportin Vjetor për Kontrata të nënshkruara gjatë vitit fiskal 2023 (formën standarde të KRPP-së);
- Konform Nenit 95, paragrafi 4, sipas kërkesave të disa Autoriteteve Kontraktuese, kemi ofruar mbështetje dhe këshilla në kryerjen e disa aktiviteteve të prokurimit;
- AQP kalkulon çmimin e karburanteve duke u bazuar në çmimin e bursës (S&P Global Platts) dhe e publikon në baza mujore në ueb faqen e AQP-së, i cili çmim përdoret për faturim nga ana e OE-ve.

7. Trajnimi

Në vitin 2024, personeli i AQP-së ndoqi programet e mëposhtme të trajnimit:

- Dy zyrtar kanë përfunduar trajnimin për Luftën kundër Marrëveshjeve të Fshehta në Prokurim Publik (Anti-Collision in Public Procurement);
- Një zyrtar ka ndjekur trajnimin strategjik për organizatat e Prokurimeve të Centralizuara (Strategic procurement training for centralized procurement organizations);
- Tre zyrtar kanë përfunduar programin bazik për prokurim publik organizuar nga KRPP në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP);
- Një zyrtar ka përfunduar programin e avancuar për prokurim publik organizuar nga KRPP në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP).
- Një zyrtar ka përfunduar trajnimin për zotim në SIMFK;
- Shih Aneksin 3.

8. Çështjet që ndikojnë në efikasitetin e AQP-së & Rekomandimet

Çështjet që ndikojnë në efikasitetin e AQP-së

- Numri i vogël i zyrtareve të prokurimit, kur dihet se DPC kryen aktivitetet e centralizuara dhe DPV zhvillon aktivitetet e prokurimit për 15 agjenci të pavarura si dhe institucionet tjera në bazë të nenit 95.4 të LPP-së;
- Mos harmonizimi i planeve të prokurimit të Agjencive të Pavarura ndikon tek DPV, ku shpesh herë jemi obliguar që të zhvillojmë disa aktivitete të prokurimit për mallra apo shërbime të njëjta, por në periudha të ndryshme kohore, që konsiderohet ndarje e kërkesave;
- Hartimi jo profesional i specifikave teknike nga Agjencitë e Pavarura shkakton humbje të kohës për DPV;
- Vonesa me kthim të përgjigjeve nga ana e AK-ve si dhe kthimi i përgjigjeve jo profesionale në disa raste;
- Emërimi i personave joprofesional si anëtarë të komisionit të vlerësimit nga ana e AK-ve.

Rekomandime për të përmirësuar efikasitetin e AQP-së:

- Shtimi i numrit të punëtorëve;
- Organizimi dhe financimi i punëtorëve nga AQP-ja në të cilat zyrtarët përgjegjës të Agjencive të Pavarura dhe zyrtarët përgjegjës të AQP-së do të marrin pjesë për të harmonizuar planet e prokurimit si dhe diskutime tjera të nevojshme.
- Hartimi i specifikimeve teknike në mënyrë profesionale dhe në përputhje me LPP nga ana e AK;
- Zyrtarët përgjegjës nga AK duhet të përgjigjen në kohë sa më të shkurtë dhe në mënyrë profesionale pasi që AQP kryen procedurat për ta dhe arritja e një kontrate të centralizuar sa më

profesionale dhe në kohë do të shërbejë për të gjitha institucionet që e shfrytëzojnë atë dhe do të ndikoj në rritjen e efikasitetit të punës së tyre;

- AK-ese për anëtare të Komisioneve të Vlerësimit të propozojnë anëtarë me njohuri profesionale mbi aktivitetet e prokurimit që zhvillohet;
- Duhet të shtohet pjesëmarrja e zyrtarëve të AQP-së, në seminare dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit në lidhje me praktikën më të mirë të prokurimit publik;


Kërkesat për vitin 2025 për përmbushjen e planeve dhe obligimeve:

- Rritja e numrit të zyrtarëve të prokurimit në Agjencinë Qendrore të Prokurimit; Kjo për arsye se kemi numër të vogël të stafit si në DPC ashtu edhe në DPV
- Shtimi i fondeve për trajnime dhe për mbulimin e shpenzimeve për angazhimin e ekspertëve në hartimin e termave të referencës/specifikimeve teknike;
- Organizimi dhe financimi nga AQP-ja i një punëtorie (në të cilin do të marrin pjesë Zyrtaret Përgjegjës të Agjencive të Pavarura dhe Zyrtaret Përgjegjës të AQP-se për harmonizimin e planeve përfundimtare të prokurimit për vitin fiskal 2025;
- Organizimi i dy punëtorive, një me zyrtarë të nivelit qendror dhe tjetra me zyrtarë të nivelit lokal për harmonizimin e kërkesave dhe qëllimeve dhe për uniformimin e dokumenteve për paraqitjen e kërkesave dhe specifikimeve teknike;
- Kërkohet disiplinë dhe përgjegjësi e njësisë kërkuese përkatësisht e Autoriteteve kontraktuese në ofrimin e shënimeve dhe specifikimeve teknike për aktivitetet e prokurimit që duhet të zhvillojë AQP-ja;
- Kërkohet që Autoritetet Kontraktuese që dërgojnë kërkesa për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit në AQP që specifikat teknike të hartojnë në mënyrë profesionale dhe në harmoni me depozitat e LPP;
- Kërkohet që Autoritetet Kontraktuese për të cilat zhvillohen aktivitetet e prokurimit për pjesëmarrje në komisione të vlerësimit të ofertave të propozojnë anëtarë që kanë njohuri lidhur me mallrat, shërbimet, punët, që prokurohen;
- Të jepet mundësia që Zyrtaret e prokurimit të AQP-se të dërgohen në seminare dhe trajnime në vende dhe jashtë vendit që ligjërohen tema nga zhvillimi i aktiviteteve të prokurimit sipas Rregulloreve dhe legjislacionit evropian.
- Të respektohen nga institucionet publike afatet kohore të vendosura nga AQP-ja për kthimin e përgjigjeve.

Arsyetim

- Përkrahja institucionale, financiare dhe kuadrovike e AQP-së do të rezultojë me kursime milionëshe, me kursim të kohës dhe mjeteve për AK;
- Po është e pritshme edhe përzgjedhja e kompanive serioze me ç'rast pritet të sigurohet furnizime dhe shërbime më cilësore dhe çka është më e rëndësishmja të gjitha institucionet publike që shfrytëzojnë kontratat e centralizuara marrin produkte dhe shërbime të njëjta, pra kontratat e centralizuara standardizojnë produktet dhe shërbimet;
- AQP gjatë punës së vet do të angazhojë edhe zyrtarë nga AK të nivelit lokal dhe qendror të cilët mund të fitojnë përvoja në punë ekipore në vlerësimin e projekteve me vlera të mëdha;
- Një AQP e përkrahur do të jetë një storie suksesi për Ministrinë e Financave dhe për AK duke siguruar kontrata të dobishme dhe duke përmbushur arsyen e ekzistimit të saj.

Aneksi 1. STRUKTURA ORGANIZATIVE



Aneksi 2. Lista e aktiviteteve të prokurimit që kanë përfunduar me nënshkrimin e kontratave nga DPV

2.1 Lista e aktiviteteve të prokurimit që kanë përfunduar me nënshkrimin e kontratave nga DPV sipas nenit 21.A të LPP-së për Agjencitë e Pavarura.

<i>Nr. rendor</i>	<i>Numri i prokurimit</i>	<i>Titulli i Kontratës</i>	<i>Data e nënshkrimit të kontratës</i>	<i>Vlera e parashikuar</i>	<i>Vlera e kontraktuar</i>	<i>Ndryshimet</i>
1	UA/2016-23-13193-1-2-1	Furnizim me pajisje tjera të Teknologjisë Informative dhe kosponete për Servera	9.1.2024.	€ 13,100.00	€ 9,961.00	€ 3,139.00
2	UA/2016-23-12630-2-2-1	Shtypja dhe zarfimi i pasqyrave, buletineve vjetore, njoftimeve mujore dhe periodike për nevojat e FKPK-së	10.1.2024.	€ 48,000.00	€ 38,880.00	€ 9,120.00
3	UA/2016-23-7913-2-2-1	Zhvillimi i platformës për aplikime online (DIGIT-ARKEP)	15.1.2024.	€ 50,000.00	€ 22,900.00	€ 27,100.00
4	UA/2016-24-244-5-5-8	Furnizim me pajisje të teknologjisë informative për nevojat e FKPK-së	23.2.2024.	€ 9,600.00	€ 4,952.00	€ 4,648.00
5	UA/2016-23-13914-2-2-1	Shërbimet e sigurimit shëndetësor për nevojat e Fondit për Kursime Pensionale të Kosovës	29.1.2024.	€ 12,000.00	€ 10,620.00	€ 1,380.00
6	UA/2016-24-843-2-4-7	Servisim dhe mirëmbajtje e një automjeti (NISSAN)	26.2.2024.	€ 960.00	€ 900.00	€ 60.00
7	UA/2016-23-11539-2-2-5	Ofrimi i shërbimeve profesionale on line në bazën e të dhënave të CI dhe shërbimeve të konsulences rregullatore sipas nevojave të ARKEP-it .	30.1.2024.	€ 72,000.00	€ 22,800.00	€ 49,200.00
8	UA/2016-23-9009-2-1-1	Krijimi i sistemit elektronik të proceseve për nevojat e Komisionit të Pavarur për Media E-KPM-ja	5.3.2024.	€ 250,000.00	€ 118,000.00	€ 132,000.00
9	UA/2016-24-667-1-2-1	Furnizim me hardver për nevojat e FKPK-së.	14.3.2024.	€ 18,000.00	€ 17,955.00	€ 45.00
10	UA/2016-24-2774-1-4-7	Furnizim dhe servisimi i sistemit të videovëzhgimit dhe shtimi i disa kamerave në sistemin ekzistues për nevojat e ARKEP	25.3.2024.	€ 990.00	€ 983.40	€ 6.60

11	UA/2016-24-2863-2-4-7	Rezervimi i një Sallë për aktivitete (konferenca, takime dhe trajnime) për nevojat e AAC-së	27.3.2024.	€ 990.00	€ 990.00	€ -
12	UA/2016-24-3270-2-4-7	Servisimi i sistemit për detektim të zjarrit për komplet Objektivin e ARKEP-it, servisi i kontrollit qasjes dhe alarmit kundër vjedhjes në server room dhe Arkivë	5.4.2024.	€ 970.00	€ 961.00	€ 9.00
13	UA/2016-24-1451-2-1-5	Mirëmbajtjen e sistemit softuerik SPECTRA për menaxhimin e spektrit frekuencore-Ritender	5.4.2024.	€ 273,000.00	€ 270,648.66	€ 2,351.34
14	UA/2016-24-2308-1-3-6	Furnizim me fasiklla specifike për nevojat e Agjencive të Pavarura	15.4.2024.	€ 5,450.00	€ 1,890.00	€ 3,560.00
15	UA/2016-24-3999-1-4-7	Furnizim me tavolinë punë për qëndrim në këmbë për nevojat e AAC-së	25.4.2024.	€ 500.00	€ 495.00	€ 5.00
16	UA/2016-24-4133-5-5-8	Furnizim me pajisje të TI-së për nevojat e Agjencive të Pavarura	21.6.2024.	€ 60,110.00	€ 57,421.60	€ 2,688.40
17	UA/2016-24-4222-1-4-7	Furnizim me frigoriferë për zyre për nevojat e KPMSHCK-së	2.5.2024.	€ 520.00	€ 512.00	€ 8.00
18	UA/2016-24-707-2-2-1	Shërbime për Auditimin e pasqyrave financiare të FKPK-së	2.5.2024.	€ 60,000.00	€ 56,400.00	€ 3,600.00
19	UA/2016-24-2703-1-3-6	Furnizim me material higjenik për nevojat e Agjencive të Pavarura	7.5.2024.	€ 5,500.00	€ 4,238.99	€ 1,261.01
20	UA/2016-24-4471-1-4-7	Furnizim me klimë 24 BTU për dhomën e serverit	8.5.2024.	€ 990.00	€ 985.00	€ 5.00
21	UA/2016-24-1517-2-1-1	Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së objekteve të agjencive të pavarura	7.5.2024.	€ 258,175.74	€ 218,884.32	€ 39,291.42
22	UA/2016-24-550-2-1-1	Mirëmbajtja e Platformës së e-Prokurimit për nevojat e KRPP-së	3.5.2024.	€ 330,000.00	€ 329,960.00	€ 40.00
23	UA/2016-24-3413-2-3-6	Software database për menaxhimin e akteve normative, administrative dhe shkresave për nevojat e AAC-së	14.5.2024.	€ 5,000.00	€ 3,999.00	€ 1,001.00
24	UA/2016-24-4025-1-3-6	Furnizim me pajisje tjera të TI-së për nevojat e Agjencive të Pavarura	13.5.2024.	€ 3,690.00	€ 2,603.50	€ 1,086.50

25	UA/2016-24-3867-2-2-1	Pjesa (LOT) II - Përzgjedhja e një eksperti të TI-se për ofrim të shërbimeve për administrim të infrastrukturës harduerike të prokurimit elektronik	17.5.2024.	€ 61,200.00	€ 60,300.00	€ 900.00
26	UA/2016-24-3867-2-2-1	Pjesa (LOT) I - Përzgjedhja e një eksperti të TI-së për ofrim të shërbimeve për administrim të aplikacionit softuerik të prokurimit elektronik	17.5.2024.	€ 61,200.00	€ 60,840.00	€ 360.00
27	UA/2016-24-5628-2-4-7	Servisimi i sistemit për shuarje automatike dhe sistemit të aspirimit në Server room dhe Arkivë për nevojat e ARKEP-it	6.6.2024.	€ 980.00	€ 972.00	€ 8.00
28	UA/2016-24-3475-2-2-1	Servisimi dhe Mirëmbajtja e Klimave për nevojat e Agjencive të Pavarura	3.6.2024.	€ 10,220.00	€ 820.80	€ 9,399.20
29	UA/2016-24-1513-2-2-1	Pjesa 7 Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të Autoritetit Rregullator për Shërbimin e Ujit	14.5.2024.	€ 1,500.00	€ 1,081.40	€ 418.60
30	UA/2016-24-1513-2-2-1	Pjesa 2 Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të Akademia e Drejtesis	14.5.2024.	€ 7,500.00	€ 1,092.02	€ 6,407.98
31	UA/2016-24-1513-2-2-1	Pjesa 3 Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të Agjencia për Informim dhe Privatësi	14.5.2024.	€ 9,000.00	€ 1,869.61	€ 7,130.39
32	UA/2016-24-1513-2-2-1	Pjesa 6 Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare	14.5.2024.	€ 15,900.00	€ 5,707.61	€ 10,192.39
33	UA/2016-24-1513-2-2-1	Pjesa 8 Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor	14.5.2024.	€ 5,000.00	€ 1,343.99	€ 3,656.01
34	UA/2016-24-1513-2-2-1	Pjesa 9 Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të Komisionit të Pavarur për Media	14.5.2024.	€ 7,200.00	€ 4,861.17	€ 2,338.83
35	UA/2016-24-1513-2-2-1	Pjesa 4 Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit	14.5.2024.	€ 9,000.00	€ 5,036.75	€ 3,963.25
36	UA/2016-24-1513-2-2-1	Pjesa 5 Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave	14.5.2024.	€ 5,000.00	€ 810.30	€ 4,189.70

37	UA/2016-24-1513-2-2-1	Pjesa 12 Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të Organit Shqyrtues të Prokurimit	14.5.2024.	€ 1,500.00	€ 845.50	€ 654.50
38	UA/2016-24-1513-2-2-1	Pjesa 14 Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të Zyres së Rregullatorit për Energji	14.5.2024.	€ 1,500.00	€ 2,335.40	€ (835.40)
39	UA/2016-24-1513-2-2-1	Pjesa 10 Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	14.5.2024.	€ 17,856.00	€ 1,968.47	€ 15,887.53
40	UA/2016-24-1513-2-2-1	Pjesa 11 Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik	14.5.2024.	€ 4,500.00	€ 1,291.06	€ 3,208.94
41	UA/2016-24-1513-2-2-1	Pjesa 13 Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të Fondit për Kursimet Pensionale të Kosovës	14.5.2024.	€ 6,000.00	€ 1,515.08	€ 4,484.92
42	UA/2016-24-1513-2-2-1	Pjesa 1 Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës	14.5.2024.	€ 15,000.00	€ 4,072.50	€ 10,927.50
43	UA/2016-24-4219-2-2-1	Angazhimi i një konsulentit në fushën e inspektimit dhe kontrollit për mbrojtjen e të dhënave personale	19.6.2024.	€ 41,400.00	€ 39,600.00	€ 1,800.00
44	UA/2016-24-3490-1-2-1	Furnizimi dhe rregullimi i pajisjeve të Server Room-it të APK-së dhe Zhvillimi Harduerik Softuerik	21.6.2024.	€ 94,000.00	€ 88,517.50	€ 5,482.50
45	UA/2016-24-5070-1-2-1	Furnizim me software për nevojat e FKPK-së	2.7.2024.	€ 11,950.00	€ 11,876.00	€ 74.00
46	UA/2016-24-3368-1-2-1	Furnizim me Klima për Nevojat e Agjencive të Pavarura	2.7.2024.	€ 15,000.00	€ 10,210.00	€ 4,790.00
47	UA/2016-24-4509-2-2-5	Ofrimi i shërbimeve profesionale on line në bazën e të dhënave të CI sipas nevojave të KPM-së	8.7.2024.	€ 10,000.00	€ 10,000.00	€ -
48	UA/2016-24-6018-1-3-6	Furnizim me sistem telefonie, audio dhe TV për nevojat e FKPK-Së	11.6.2024.	€ 4,700.00	€ 4,635.00	€ 65.00
49	UA/2016-24-5616-2-2-1	Kontraktimi i një eksperti në fushën e IT-së për Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave	19.7.2024.	€ 10,000.00	€ 2,980.00	€ 7,020.00

50	UA/2016-24-5877-2-3-6	Krijimi i ueb-faqes së re të Autoritetit të Konkurrencës	22.7.2024.	€ 1,290.00	€ 796.50	€ 493.50
51	UA/2016-24-5260-2-2-1	Kontraktimi i një eksperti për shërbime ligjore për nevojat e KPM-së	23.7.2024.	€ 26,000.00	€ 25,350.00	€ 650.00
52	UA/2016-24-5560-1-2-1	Furnizim me paisje për përkthim për nevojat e Akademisë së Drejtësisë	29.7.2024.	€ 50,000.00	€ 48,548.51	€ 1,451.49
53	UA/2016-24-8016-5-5-8	Furnizim me pajisje të TI-së për nevojat e Agjencive të Pavarura	6.9.2024.	€ 45,056.80	€ 40,760.56	€ 4,296.24
54	UA/2016-24-8016-5-5-8	Furnizim me pajisje të TI-së për nevojat e Agjencionit për Parandalimin e Korrupsionit	6.9.2024.	€ 15,700.00	€ 13,034.52	€ 2,665.48
55	UA/2016-24-8083-1-4-7	Furnizim me frigorifer për zyre	8.8.2024.	€ 600.00	€ 572.00	€ 28.00
56	UA/2016-24-8664-5-5-8	Furnizim me pajisje të IT-së për nevojat e ARRU-së	13.9.2024.	€ 14,000.00	€ 9,248.78	€ 4,751.22
57	UA/2016-24-8606-1-4-7	Furnizim dhe montim i panel dritave dhe trafave sipas nevojave të ARKEP-it	21.8.2024.	€ 990.00	€ 980.00	€ 10.00
58	UA/2016-24-5503-2-3-6	Inicimin për angazhimin e një ekspertit për ofrimin e konsulencës për Implementimin e projektit për bartshmërinë e numrave për nevojat e ARKEP-it	18.8.2024.	€ 5,000.00	€ 5,000.00	€ -
59	UA/2016-24-8117-2-3-6	Demontimi i radio pajisjeve antenave nga shtyllat telekomunikuese	26.8.2024.	€ 3,500.00	€ 3,498.00	€ 2.00
60	UA/2016-24-8811-2-4-7	Ripërtëritje e certifikatave dhe ueb hosting -ut për domenin e ZRRE -së	28.8.2024.	€ 999.00	€ 990.00	€ 9.00
61	UA/2016-24-7868-2-3-6	Kontraktor individual për përgatitjen e specifikimit teknik në projektin Përditësimi i sistemit për monitorimin e mediave për vitet 2024 dhe 2025 për nevojat e KPM-së	2.9.2024.	€ 3,000.00	€ 2,100.00	€ 900.00
62	UA/2016-24-7518-2-2-1	Shërbime të Transportit Ajror për nevojat e Agjencive të Pavarura	2.9.2024.	€ 98,800.00	€ 96,332.47	€ 2,467.53
63	UA/2016-24-5061-1-2-1	Furnizim me pajisjet e nevojshme dhe zhvillimin e sistemit iCloud(Virtualizimi i sistemeve kompjuterike)	6.9.2024.	€ 100,000.00	€ 88,750.00	€ 11,250.00

64	UA/2016-24-9791-5-5-8	Furnizim me materiale të shtypura dhe dizajn-botime dhe publikime për nevojat e AD	7.11.2024.	€ 35,919.81	€ 16,879.56	€ 19,040.25
65	UA/2016-24-9791-5-5-8	Furnizim me material për zyre për nevojat së KPMSHCK	7.11.2024.	€ 2,250.00	€ 1,650.00	€ 600.00
66	UA/2016-24-3136-2-1-1	Sigurimi fizik i objekteve për nevojat e agjencive të pavarura	20.9.2024.	€ 553,000.00	€ 466,761.24	€ 86,238.76
67	UA/2016-24-10538-5-5-8	Furnizim me materiale me logo të 20 vjetorit të ARKEP-it	1.11.2024.	€ 6,000.00	€ 3,455.00	€ 2,545.00
68	UA/2016-24-11145-1-4-7	Furnizim me veshmbathje sigurie për inspektor për nevojat e AAC-së	24.10.2024.	€ 950.00	€ 943.00	€ 7.00
69	UA/2016-24-11077-1-4-7	Furnizim me Rezervuar të naftës për gjenerator (Metalik)1000 Litra	25.10.2024.	€ 999.00	€ 965.00	€ 34.00
70	UA/2016-24-11260-1-4-7	Furnizim me Televizor për nevojat e AIP-it	29.10.2024.	€ 998.00	€ 928.00	€ 70.00
71	UA/2016-24-11458-5-5-8	Furnizim me material administrativ për konferencën “Java e Integritetit në Kosovë për nevojat e APK-së	21.11.2024.	€ 4,000.00	€ 1,366.00	€ 2,634.00
72	UA/2016-24-11455-2-4-7	Ndërrim, balancim dhe hotelim të gomave për nevojat e ARKEP-it	4.11.2024.	€ 990.00	€ 990.00	€ -
73	UA/2016-24-8404-2-1-1	Lot I System for Locating Transmitter and Interference Sources	7.11.2024.	€ 180,000.00	€ 179,427.40	€ 572.60
74	UA/2016-24-8404-2-1-1	Lot II ICS Telecom and ICS manager upgrade(last version)advanced software solutions for spectrum management	7.11.2024.	€ 78,000.00	€ 77,490.60	€ 509.40
75	UA/2016-24-9419-2-2-1	Software për dizajnim të sipërfaqeve të mbrojtura nga pengesa e aerodromeve për nevojat e AAC-së	11.11.2024.	€ 15,000.00	€ 14,449.00	€ 551.00
76	UA/2016-24-11762-2-3-5	Ceremonia e 20 Vjetorit Jubilar të ARKEP-it	12.11.2024.	€ 6,000.00	€ 2,675.00	€ 3,325.00
77	UA/2016-24-9463-1-2-1	Furnizim me pajisje për konsolidimin e sajtit të dytë të prokurimit publik për nevojat e KRPP_së	14.11.2024.	€ 85,000.00	€ 84,995.00	€ 5.00
78	UA/2016-24-12118-1-4-7	Furnizim me kamera për sistemin ekzistues NVR ACTI NVR ZNR-423	18.11.2024.	€ 950.00	€ 892.50	€ 57.50

79	UA/2016-24-12184-1-4-7	Furnizim me sistem automatik për hapjen dhe mbylljen e dyerve të oborrit të objektit të APK-së	19.11.2024.	€ 750.00	€ 750.00	€ -
80	UA/2016-24-9872-2-3-6	Konfigurimi i një Serveri Virtual (WM) në Infrastrukturën aktuale të TI-së së KPM-së	21.11.2024.	€ 8,000.00	€ 3,777.70	€ 4,222.30
81	UA/2016-24-8655-1-2-1	Lot I- Furnizim me UPS dhe Access Switch	21.11.2024.	€ 41,500.00	€ 17,240.00	€ 24,260.00
82	UA/2016-24-8655-1-2-1	Lot II- Furnizim me sistem të videokonferencës	21.11.2024.	€ 18,500.00	€ 9,231.00	€ 9,269.00
83	UA/2016-24-11655-2-3-5	Zhvendosja e pajisjeve të monitorim të pajisjeve tjera të TI-së për nevojat e KPM-së	22.11.2024.	€ 8,500.00	€ 8,414.44	€ 85.56
84	UA/2016-24-12753-5-5-8	Furnizim me material zyrtar për nevojat e Agjencive të Pavarura	26.12.2024.	€ 6,100.00	€ 2,056.80	€ 4,043.20
85	UA/2016-24-13272-1-4-7	Furnizim me Licenca Microsoft Office 365 për 1 muaj	18.12.2024.	€ 800.00	€ 672.00	€ 128.00
86	UA/2016-24-12596-5-3-6	Renovimi i objektit të KPM-së	19.12.2024.	€ 5,000.00	€ 3,130.00	€ 1,870.00
87	UA/2016-24-9212-2-2-1	Mirëmbajtja e web faqes së ARKEP-it	19.12.2024.	€ 18,500.00	€ 14,820.00	€ 3,680.00
88	UA/2016-24-9212-2-2-1	Mirëmbajtja e portalit KOS-CERT dhe vazhdimi të sistemit të emailave, domenit, hostimit, SSL Certifikatës dhe GreenBar-it	18.12.2024.	€ 2,500.00	€ 2,298.60	€ 201.40
89	UA/2016-24-10054-2-3-6	Zhvendosja (bartja) e inventarit të KPM-së në objektin e ri	13.11.2024.	€ 7,000.00	€ 3,800.00	€ 3,200.00
TOTALI				€ 3,358,794.35	€ 2,778,541.81	€ 580,252.54

2.2 Lista e aktiviteteve të prokurimit që kanë përfunduar me nënshkrimin e kontratave nga DPV sipas nenit 95.4 të LPP-së për Agjencitë e Pavarura.

2.2.1.Lista e kontratave të nënshkruar nga AQP në emër të Agjencisë të Punësimit të Republikës së Kosovës.

<i>Nr. rendor</i>	<i>Numri i prokurimit</i>	<i>Titulli i Kontratës</i>	<i>Data e nënshkrimit të kontratës</i>	<i>Vlera e parashikuar</i>	<i>Vlera e kontraktuar</i>	<i>Ndryshimet</i>
1	UA/2016-24-3063-2-2-1	Servisimi, Mirëmbajtja e Aparateve kundër zjarrit, hidrantëve dhe Rrufepritësve	14.5.2024.	€ 10,000.00	€ 8,272.00	€ 1,728.00
2	UA/2016-24-3402-1-2-1	Furnizim me pajisje për nevojat e Qendrave te Aftësiemeve Profesionale- APRK	13.5.2024.	€ 50,000.00	€ 48,786.00	€ 1,214.00
3	UA/2016-24-5472-5-2-1	Renovimi i Qendres së Aftësimit Profesional- Pejë-APRK	26.7.2024.	€ 30,000.00	€ 11,800.00	€ 18,200.00
4	UA/2016-24-6534-1-3-6	Furnizim me kondicioner për nevojat e APRK-së	26.7.2024.	€ 5,000.00	€ 3,948.00	€ 1,052.00
5	UA/2016-24-7042-1-3-6	Furnizim me veshmbathje për profesionin kuzhinier për nevojat e Qendrave te Aftësiemeve Profesionale ne Gjilan dhe Pejë-APRK	5.8.2024.	€ 2,000.00	€ 1,830.00	€ 170.00
6	UA/2016-24-6783-2-3-6	Mbikëqyrja profesionale e projekteve (kontratave për punë) për APRK	2.8.2024.	€ 3,500.00	€ 1,295.00	€ 2,205.00
7	UA/2016-24-7050-2-3-6	Servisimi i ashensorëve në Qendrat për Aftësim Profesional(QAP)	13.8.2024.	€ 8,000.00	€ 7,175.00	€ 825.00
8	UA/2016-24-6503-5-2-1	Renovimi i Zyrës së Punësimit në Shtime	26.8.2024.	€ 13,600.32	€ 8,777.77	€ 4,822.55
9	UA/2016-24-6503-5-2-1	Renovimi i Zyrës së Punësimit në Lipjan	26.8.2024.	€ 11,531.52	€ 6,733.33	€ 4,798.19
10	UA/2016-24-6503-5-2-1	Renovimi i Zyrës së Punësimit në Istog	26.8.2024.	€ 13,368.16	€ 9,319.86	€ 4,048.30
11	UA/2016-24-7026-1-2-1	Furnizimi me Material Trajnimi për Qendrat e Aftësimit Profesional - APRK	6.9.2024.	€ 60,000.00	€ 53,733.56	€ 6,266.44
12	UA/2016-24-7836-2-2-1	Pastrimi dhe mirëmbajtja teknike e objekteve e Zyrrav të APRK-se	24.9.2024.	€ 15,000.00	€ 9,025.56	€ 5,974.44
13	UA/2016-24-9012-2-2-1	Servisimi i ngrohjeve Qendrore ne Zyret e Punesimit dhe Qendrat e Aftesimit Profesional- APRK	30.8.2024.	€ 10,000.00	€ 3,892.50	€ 6,107.50
14	UA/2016-24-9069-5-2-1	Brendimi i Zyreve të Punësimit në Mitrovicë	31.10.2024.	€ 65,000.00	€ 61,933.24	€ 3,066.76

15	UA/2016-24-9069-5-2-1	Brendimi i Zyreve të Punësimit në Ferizaj	31.10.2024.	€ 65,000.00	€ 56,538.00	€ 8,462.00
16	UA/2016-24-7835-2-1-1	LLOT 3 Angazhimi i një trajneri për profesionin e Rrobaqepësisë për nevoja të QAP- it në Gjakovë	11.11.2024.	€ 27,000.00	€ 26,640.00	€ 360.00
17	UA/2016-24-7835-2-1-1	LLOT 9 Angazhim i një trajneri për profesionin e Instalues Elektrik Instalues i paneleve solare për nevoja të QAP- it në Gjakovë	12.11.2024.	€ 27,000.00	€ 26,820.00	€ 180.00
18	UA/2016-24-7835-2-1-1	LLOT 2 Angazhimi i një trajneri për profesionin e kuzhinier për nevoja të QAP- it në Gjakovë	11.11.2024.	€ 19,800.00	€ 19,620.00	€ 180.00
19	UA/2016-24-7835-2-1-1	LLOT 8 Angazhimi i një trajneri për profesionin e Parukeri grim për nevoja të QAP- it në Gjakovë	11.11.2024.	€ 19,800.00	€ 19,620.00	€ 180.00
20	UA/2016-24-7835-2-1-1	LLOT 15 Angazhimi i një trajneri për profesionin Metalpunues për nevoja të QAP- it në Gjakovë	11.11.2024.	€ 27,000.00	€ 26,100.00	€ 900.00
21	UA/2016-24-7835-2-1-1	LLOT 17 Angazhimi i një trajneri për profesionin Nëpunës Kontabiliteti Administrim Biznesi për nevoja të QAP- it në Gjilan	11.11.2024.	€ 27,000.00	€ 23,724.00	€ 3,276.00
22	UA/2016-24-7835-2-1-1	LLOT 18 Angazhimi i një trajneri për profesionin Nëpunës Kontabiliteti Administrim Biznesi për nevoja të QAP- it në Prishtinë	12.11.2024.	€ 27,000.00	€ 23,364.00	€ 3,636.00
23	UA/2016-24-7835-2-1-1	LLOT 10 Angazhimi i një trajneri për profesionin e Instalues Elektrik Instalues i paneleve solare për nevoja të QAP- it në Prizren	21.11.2024.	€ 27,000.00	€ 27,000.00	€ -
24	UA/2016-24-7835-2-1-1	LLOT 12 Angazhimi i një trajneri për profesionin Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit Instalues i ngrohjes qendrore për nevoja të QAP- it në Prizren	21.11.2024.	€ 27,000.00	€ 25,000.00	€ 2,000.00
25	UA/2016-24-12173-2-4-7	Mbikëqyrja profesionale e projekteve “Brendimi i Zyrrave të Punësimit Mitrovice dhe Ferizaj”.	21.11.2024.	€ 980.00	€ 959.85	€ 20.15

26	UA/2016-24-13044-2-4-7	Sigurim i Automjetit Peugeot për APRK	13.12.2024.	€ 140.00	€ 137.47	€ 2.53
27	UA/2016-24-8875-2-1-1	Shërbimet e sigurimit fizik të objekteve të APRK-së	4.12.2024.	€ 180,000.00	€ 116,820.00	€ 63,180.00
TOTALI				€ 771,720.00	€ 628,865.14	€ 142,854.86

2.2.2. Lista e kontratave të nënshkruar nga AQP në emër të Agjencisë për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar

<i>Nr. rendor</i>	<i>Numri i prokurimit</i>	<i>Titulli i Kontratës</i>	<i>Data e nënshkrimit të kontraktues</i>	<i>Vlera e parashikuar ne €</i>	<i>Vlera e kontraktuar ne €</i>	<i>Ndryshimet</i>
1	UA/2016-24-9283-5-5-8	Furnizim me pajisje te TI-së për nevojat e AMIK-ut dhe AIP-it	22.10.2024.	€ 16,500.00	€ 12,737.00	€ 3,763.00
2	UA/2016-24-9729-2-4-7	Shpenzime për grupe të punës për nevojat e AMIK-ut	18.9.2024.	€ 990.00	€ 988.00	€ 2.00
3	UA/2016-24-9656-2-2-1	Servisimi dhe mirëmbajtja e automjetit Mercedes - BENZ 245 G për nevojat e AMIK-ut	5.11.2024.	€ 10,000.00	€ 4,101.30	€ 5,898.70
4	UA/2016-24-11457-1-3-6	Furnizim me frigorifer dhe dispanzer të ujit për nevojat e AMIK-ut	3.12.2024.	€ 1,500.00	€ 980.00	€ 520.00
5	UA/2016-24-11467-1-3-6	Furnizim me pajisje për nevojat e AMIK-ut	23.12.2024.	€ 4,500.00	€ 1,527.00	€ 2,973.00
1	UA/2016-24-9283-5-5-8	Furnizim me pajisje te TI-së për nevojat e AMIK-ut dhe AIP-it	22.10.2024.	€ 16,500.00	€ 12,737.00	€ 3,763.00
Gjithsejtë:				€ 33,490.00	€ 20,333.30	€ 13,156.70

2.2.3. Lista e kontratave të nënshkruar nga AQP në emër të Thesarit të Republikës së Kosovës.

<i>Nr. rendor</i>	<i>Numri i prokurimit</i>	<i>Titulli i Kontratës</i>	<i>Data e nënshkrimit të kontraktues</i>	<i>Vlera e parashikuar ne €</i>	<i>Vlera e kontraktuar ne €</i>	<i>Ndryshimet</i>
1	UA/2016-24-2170-2-2-5	Mirëmbajtja e Sistemit të Menaxhimit të Borxhit Shtetëror – CS-DRMS	9.12.2024.	€ 30,000.00	€ 28,615.00	€ 1,385.00

2.2.4. Lista e kontratave të nënshkruar nga AQP në emër të Agjencisë Kosovare për Inteligjencë

<i>Nr. rendor</i>	<i>Numri i prokurimit</i>	<i>Titulli i Kontratës</i>	<i>Data e nënshkrimit të kontraktues</i>	<i>Vlera e parashikuar ne €</i>	<i>Vlera e kontraktuar ne €</i>	<i>Ndryshimet</i>
1	UA/2016-24-11548-5-5-8	Furnizim me material zyrtar për nevojat e AKI-së	21.11.2024.	€ 8,000.00	€ 5,485.60	€ 2,514.40

Aneksi 3. TABELA E PJESEMARRSVE NE TRAJNIME

Anti-Collision in Public Procurement – provided by the U.S. Department of Justice, Anti Trust Division, Budapest, Hungary, June 24-28, 2024		
1. Fation Alaj	Zv. Drejtor i drejtoratit për Prokurime të Veçanta	fation.alaj@rks-gov.net
2. Ardi Mehmeti	Udhëheqës i sektorit të Prokurimeve të Centralizuara	ardi.mehmeti@rks-gov.net
PPE+ Europe 2024 - Strategic procurement training for centralized procurement organizations Filluar me 4 nëntor 2024 – në proces (përfundon me 21.03.2025)		
1. Luljeta Lokaj	Zyrtare e lartë e Prokurimit	luljeta.lokaj@rks-gov.net
Programi bazik i prokurimit		
1. Libona Thaçi	Zyrtare e lartë e Prokurimit	libona.thaqi@rks-gov.net
2. Blerina Haziraj	Zyrtare e Prokurimit	blerina.haziraj@rks-gov.net
3. Liridona Malaj	Zyrtare e Prokurimit	liridona.malaj@rks-gov.net
Programi i avancuar i prokurimit		
1. Fation Alaj	Zv. Drejtor i drejtoratit për Prokurime të Veçanta	fation.alaj@rks-gov.net
Trajnim për Zotime të mjeteve në SIMFK		
1. Qendresa Maliqi	Zyrtare e Ligjore	qendresa.maliqi@rks-gov.net